VENDIM
Nr. 58, datë 13.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.11.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (M) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Mimoza Bruzia, përfaqësuar nga avokat Aqif Peza, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1730, datë 20.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1522, datë 24.11.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-1513, datë 22.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Baza Ligjore: Nenet 30, 31, 32, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", 142, pika 1 dhe 146, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 5 dhe 6, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Mimoza Bruzia ka ushtruar detyrën e specialistes së ngarkuar me vlera pranë arkës për veprim në Bankën e Shqipërisë, në periudhën 2009–2014. Në datën 21.7.2014, Banka e Shqipërisë ka depozituar një kallëzim kundër shtetasit A. B., me detyrë përgjegjës i arkës për veprim, me akuzën e përvetësimit të një shume të konsiderueshme parash. Gjatë hetimit ka rezultuar se për këto fakte ka pasur dijeni edhe kërkuesja, e cila ka lejuar shtetasin A. B. të vijojë veprimet e paligjshme gjatë kohës që ushtronte detyrën, por edhe pas largimit të tij. Për pasojë, në datën 24.7.2014, ndaj saj është vendosur masa e sigurimit personal "Arresti në burg".

2. Në përfundim të hetimeve, prokuroria ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të shtetasit A. B. dhe kërkueses, me akuzën e kryerjes së veprës penale "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit", të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i Kodit Penal (*KP*), me

dyshimin se kjo e fundit ka bashkëpunuar me shtetasin A. B. për të kryer vjedhjen gjatë një afati kohor prej 4 vjetësh.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila e ka shqyrtuar çështjen sipas ritit të gjykimit të shkurtuar, në bazë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), në përfundim, me vendimin nr. 1730, datë 20.5.2015, ka vendosur deklarimin fajtore të kërkueses për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i KP-së dhe dënimin e saj me 10 vjet burgim. Ajo gjykatë, në analizë të fakteve dhe provave, ka arritur në konkluzionin se janë konsumuar plotësisht elementet e veprës penale për të cilën akuzohet kërkuesja, e cila, me veprime konkludente, ka lejuar që shtetasi A. B. të vazhdojë për disa vjet vjedhjen e parave, pavarësisht se detyra e saj ishte administrimi i këtyre vlerave monetare. Edhe pse kërkuesja ka pasur dijeni për këtë veprimtari, e ka lejuar të pandehurin tjetër të futet në ambientet e arkës edhe pasi ai ishte larguar nga detyra. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja dhe i pandehuri tjetër, shtetasi A. B.

4. Gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes në themel në Gjykatën e Apelit Tiranë, në seancën e datës 24.11.2016, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, përmes një kërkese me shkrim nga mbrojtësi i saj, kërkuesja i ka kërkuar gjykatës të konstatojë humbjen e fuqisë së masës së sigurimit personal "Arresti në burg", me pretendimin se ndodhej në kushtet e shkronjës "c", të pikës 3, të nenit 263 të KPP-së, i cili parashikon se paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar 9 muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit. Gjykata e apelit ka çmuar të mos shprehej në atë moment procedural për bazueshmërinë ose jo të kërkesës, por të vijonte me shqyrtimin e çështjes, me arsyetimin se përgjigjja e kësaj kërkese varej nga përfundimi i gjykimit dhe zgjidhja në themel e çështjes. Ndërkohë, po në këtë seancë gjyqësore, gjykata e apelit ka përfunduar gjykimin në themel të çështjes, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se ai ishte i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë edhe kërkuesja.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1513, datë 22.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekurseve, përfshirë edhe atë të kërkueses, me arsyetimin se shkaqet e paraqitura në to nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit, në kuptim të nenit 432 të KPP-së. Sipas atij kolegji, në rastin në shqyrtim, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit penal nga gjykatat më të ulëta dhe ato nuk kanë bërë shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit, sipas nenit 128 të KPP-së, ose shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në dëm të kërkueses.

6. Në datën 16.3.2023, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në këtë Gjykatë në datën 28.3.2023. Kolegji i Gjykatës në datën 31.5.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e gjykatave i kanë cenuar:

7.1. *Lirinë personale*, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, pasi ajo ka qëndruar në paraburgim nga data 20.5.2015, në të cilën është dhënë vendimi i fajësisë në gjykatën e shkallës së parë, deri në datën 24.11.2016, kur është dhënë vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke u tejkaluar afati ligjor 9-mujor, i parashikuar nga neni 263, paragrafi 3, shkronja "c", i KPP-së. Gjykata e Apelit nuk është shprehur në seancë me vendim të ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit "Arresti në burg" dhe as në vendimin përfundimtar. Edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka pranuar se periudha e paraburgimit gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit e ka tejkaluar afatin ligjor 9-mujor të përcaktuar në dispozitën e mësipërme.

7.2. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.2.1. Së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit substancial, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs, të cilat kishin të bënin me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor. Gjykata e Lartë duhej t'i analizonte këto pretendime dhe jo të vendoste mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit.

7.2.2. Së drejtës për t'u mbrojtur dhe asaj për t'u dëgjuar, pasi nisur nga fakti se kërkuesja ka ngritur pretendime në lidhje me kualifikimin e drejtë të veprës penale, Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, me praninë e palëve.

7.2.3. Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi gjykatat janë nisur nga karakteri sensitiv i çështjes dhe kanë dhënë një vendim të padrejtë. Megjithëse ato kanë pranuar se kërkuesja ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së, në përfundim e kanë dënuar atë për veprën penale "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit", të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i KP-së. Gjatë gjykimit të çështjes nuk është provuar që kërkuesja të ketë kryer veprën penale në bashkëpunim, pasi në referim të dispozitave penale dhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë mungon elementi i marrëveshjes midis personave që kanë kryer veprën penale.

7.2.4. Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi gjykimi i çështjes penale në ngarkim të kërkueses ka filluar në vitin 2015 dhe ka përfunduar në datën 22.11.2022, pra ka zgjatur për më shumë se 7 vjet, duke tejkaluar çdo afat të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile (*KPC*).

8. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme****,* ka prapësuar se:

8.1. Pretendimi për cenimin e *lirisë personale* është i pabazuar. Gjykata e apelit ka vlerësuar se nuk ka shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg". Edhe pse afati i paraburgimit, sipas nenit 263, paragrafi 3, shkronja "c", të KPP-së kishte përfunduar, kërkuesja i është drejtuar me kërkesë gjykatës së apelit vetëm në 24.11.2016, në seancën e parë të gjykimit të themelit të çështjes së saj. Kujdesi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit u përket të gjitha subjekteve të procedimit, por në veçanti subjektit që i cenohen ato. Në këtë kuptim, për periudhën nga data e kalimit të afatit dhe deri ditën e gjykimit të çështjes, kërkuesja nuk ka kërkuar lirimin nga paraburgimi, duke mos ngritur pretendime për cenimin e lirisë personale, ndaj ajo nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion përpara ngritjes së një pretendimi të tillë në nivel kushtetues. Pretendimi i kërkueses ka marrë përgjigje edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila është shprehur se me shpalljen e vendimit të gjykatës së apelit, masa e sigurimit ndaj kërkueses, gjithsesi, është shuar për shkak të ligjit, ndërsa ajo ka marrë statusin e të dënuarës dhe tashmë qëndron në burgim dhe jo paraburgim, çka bën të pamundur lirimin e saj mbi shkakun e humbjes së fuqisë së paraburgimit në kuptim të nenit 263, paragrafi 3, shkronja "c", të KPP-së, ndërkohë që periudha e paraburgimit përllogaritet në masën e dënimit që ajo duhet të shlyejë. Gjykatat kanë konstatuar qëndrimin në paraburgim të kërkueses tej afatit ligjor 9-mujor të përcaktuar në dispozitën në fjalë, duke u shprehur edhe për mënyrën e rivendosjes së të drejtës së shkelur asaj, pikërisht përmes llogaritjes, sipas përcaktimeve të nenit 57 të KP-së, edhe të kësaj periudhe paraburgimi në masën e dënimit që ajo duhet të vuajë.

8.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit dhe së drejtës së ankimit substancial*, është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka analizuar dhe kthyer përgjigje edhe për themelin e pretendimeve të kërkueses, duke vendosur mospranimin e rekursit për shkak të mungesës së shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Vendimi paraqitet i qartë dhe pa kundërthënie dhe pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat, shkaqet e rekursit dhe pjesa arsyetuese është në harmoni me konkluzionin se në rastin konkret nuk ka mosrespektim të ligjit penal nga gjykatat e faktit.

8.3. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar*, argumentet e kërkueses nuk lidhen me kuptimin që jurisprudenca kushtetuese i jep kësaj të drejte dhe nuk konstatohet asnjë e dhënë që lidhet me institutin e mbrojtjes efektive. Pretendimet e parashtruara në rekurs janë arsyetuar nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të kërkueses, duke realizuar në këtë mënyrë të drejtën për mbrojtje efektive.

8.4. Pretendimin për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* kërkuesja e ka bazuar vetëm në natyrën sensitive të çështjes, duke mos e argumentuar mjaftueshëm se si është

cenuar kjo e drejtë. Pretendimet e saj, gjithashtu, janë me natyrë ligjore dhe nuk i përkasin juridiksionit kushtetues, për rrjedhojë ajo nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi nuk ka arritur t'i ngrejë ato në nivel kushtetues.

8.5. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi në kuptim të neneve 399/1–399/12 të KPC-së, kërkesa për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin bëhet nga gjykatat e zakonshme dhe jo drejtpërdrejt në Gjykatë. Vonesa në gjykimin e çështjes ka ardhur si pasojë e pamundësisë objektive të gjykimit për shkak të akumulimit të përkohshëm të çështjeve dhe mungesës së kapaciteteve njerëzore për përballimin e kësaj situate.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në këtë këndvështrim, kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë *(shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

12. Kërkuesja ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi gjykimi i çështjes penale në ngarkim të saj ka filluar në vitin 2015 dhe ka përfunduar në datën 22.11.2022 (me vendimin e Gjykatës së Lartë), pra për më shumë se 7 vjet, duke tejkaluar afatet e parashikuara nga KPC-ja që përcaktojnë kohëzgjatjen e arsyeshme. Gjykata vëren se ky pretendim është parashtruar për herë të parë drejtpërdrejt përpara saj, duke mos shteruar kërkuesja, paraprakisht, mjetet juridike efektive që ofron legjislacioni në fuqi, në kuptim të parashikimeve të neneve 399/1–399/12 të KPC-së. Sipas jurisprudencës kushtetuese, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit, duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon ky kod, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se për këtë pretendim kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

13. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera në ankimin kushtetues individual, për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte të saj, Gjykata vëren se

kërkuesja i ka ngritur më parë në formë dhe në substancë përpara gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë konsiderohet se e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

14. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 22.11.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 16.3.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e lirisë personale, si dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial, së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar, si dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

16. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, Gjykata çmon se kërkuesja ka argumentuar se gjykatat janë nisur nga karakteri sensitiv i çështjes dhe se kanë dhënë një vendim të padrejtë, por pa arritur ajo të provojë nga pikëpamja kushtetuese cenimin e kësaj të drejte në aspektin objektiv ose subjektiv të saj. Vetëm fakti se gjykatat, në përfundim të gjykimit, kanë vendosur deklarimin fajtore dhe dënimin e kërkueses për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohej, nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur këtë pretendim, në kushtet kur vendimmarrja e gjykatave të zakonshme është rezultat i vlerësimit të fakteve dhe provave të administruara dhe interpretimit e zbatimit të ligjit procedural e material penal. Për rrjedhojë, kërkuesja nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të tij. Po në drejtim të këtij pretendimi, argumentet e kërkueses se nuk është provuar që të ketë kryer veprën penale në bashkëpunim, pasi mungon elementi i marrëveshjes midis personave që kanë kryer veprën penale, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të rastit, që përfshihen në kompetencat e gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues.

17. Për sa u përket pretendimeve të kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial, si dhe të së drejtës për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, mbështetur në natyrën e tyre dhe thelbin e argumenteve, Gjykata çmon t'i trajtojë në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit. Ky pretendim, ashtu si edhe pretendimi për cenimin e lirisë personale, hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj bazueshmëria e tyre në themel do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

18. Sipas kërkueses, ajo ka qëndruar në paraburgim përtej afatit 9-mujor të parashikuar në nenin 263, paragrafi 3, shkronja "c", të KPP-së, në pritje të gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit. Sipas saj, paraburgimi ka humbur fuqinë pas kalimit të këtij afati të llogaritur nga data 20.5.2015 e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë, në kushtet e mosgjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, e cila, në fakt, e ka dhënë vendimin e saj mbas 18 muajve, në datën 24.11.2016. Gjykata e Apelit Tiranë nuk është shprehur në seancë me vendim të ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit "Arresti në burg" dhe as në vendimin përfundimtar. Qëndrimi në paraburgim, tej afatit ligjor 9-mujor, në pritje të gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, është pranuar edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj.

19. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi gjykata e apelit nuk mund të shprehej menjëherë për kërkesën e kërkueses për shuarjen e masës së sigurimit, ndërkohë që në vendimin e saj përfundimtar, pasi ka vlerësuar se një kërkesë e tillë është paraqitur në të njëjtën ditë kur gjykohej çështja e themelit dhe për sa kohë arrinte në përfundimin se vendimi i dënimit i gjykatës së shkallës së parë për kërkuesen duhet të lihej në fuqi, ajo është shprehur se nuk ka shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg", sepse vendimi i saj është i formës së prerë dhe menjëherë i ekzekutueshëm. Kujdesi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit u përket të gjitha subjekteve të procedimit, por në veçanti subjektit që i cenohen ato. Në këtë kuptim, për periudhën nga data e kalimit të afatit dhe deri ditën e gjykimit të çështjes, kërkuesja nuk ka kërkuar lirimin nga paraburgimi, duke mos ngritur pretendime për cenimin e lirisë personale, ndaj ajo nuk ka shteruar mjetet juridike në

dispozicion përpara ngritjes së një pretendimi të tillë në nivel kushtetues. Pretendimi i kërkueses ka marrë përgjigje edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila është shprehur se me shpalljen e vendimit të gjykatës së apelit, masa e sigurimit ndaj kërkueses, gjithsesi, është shuar për shkak të ligjit, ndërsa ajo ka marrë statusin e të dënuarës dhe tashmë qëndron në burgim dhe jo paraburgim, çka bën të pamundur lirimin e saj mbi shkakun e humbjes së fuqisë së paraburgimit në kuptim të nenit 263, paragrafi 3, shkronja "c", të KPP-së, ndërkohë që periudha e paraburgimit përllogaritet në masën e dënimit që ajo duhet të shlyejë. Në këtë kuptim, gjykatat kanë konstatuar qëndrimin në paraburgim të kërkueses tej afatit ligjor 9-mujor të përcaktuar në dispozitën në fjalë, duke u shprehur edhe sa i përket mënyrës së rivendosjes së të drejtës të shkelur, pikërisht përmes llogaritjes, sipas përcaktimeve të nenit 57 të KP-së, edhe të kësaj periudhe paraburgimi në masën e dënimit që ajo duhet të vuajë.

20. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, të cilat parashikohen në mënyrë të detajuar në KPP. Neni 27, pika 2, i Kushtetutës parashikon rastet e kufizimit të lirisë personale, ndërsa shkronja "a" e kësaj dispozite kushtetuese parashikon, ndër të tjera, kur individi është dënuar me burgim nga gjykata kompetente.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor të masave të sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë *(shih vendimet nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) është shprehur në jurisprudencën e saj se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveç rasteve të parashikuara në nenin 5 të KEDNJ-së dhe vetëm bazuar në ligj (*shih vendimin e GJEDNJ-së Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 13229/03, § 67, datë 28.1.2008*). Ajo i referohet edhe cilësisë së ligjit, i cili duhet të jetë në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, mjaftueshëm i aksesueshëm, i saktë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që të shmanget çdo rrezik për arbitraritet (*shih vendimin e GJEDNJ-së Mooren kundër Gjermanisë [DhM], § 76, datë 9.7.2009*). Kështu, standardi i "ligjshmërisë" i vendosur nga Konventa kërkon që i gjithë ligji të jetë mjaft i saktë për t'i lejuar personit - nëse është e nevojshme, me këshillat e duhura – të parashikojë, në një shkallë që është e arsyeshme në rrethanat konkrete, pasojat e një veprimi të caktuar (*shih vendimet e GJEDNJ-së Grubic kundër Kroacisë, § 37, datë 30.10.2012; Steel dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 54, datë 23.9.1998*).

23. Dispozitat procedurale penale parashikojnë rregulla të hollësishme për revokimin, zëvendësimin ose shuarjen e masave të sigurimit, për kohëzgjatjen e paraburgimit dhe pezullimin e afateve të paraburgimit, të përmbledhura në kreun IV "Revokimi dhe shuarja e masave të sigurimit" të titullit V "Masat e sigurimit" të pjesës së parë të KPP-së. Kështu, neni 261 përcakton rastet kur masat e sigurimit shuhen, si dhe kompetencën e gjykatës për të vendosur mbi kërkesat për shuarjen e tyre brenda 48 orëve (pika 3). Neni 262 rregullon pasojat e shuarjes së masave të sigurimit, ku për sa i përket masës së arrestit, humbja e fuqisë së tij sjell si pasojë lirimin e menjëhershëm të personit nga gjykata. Më tej, neni 263 rregullon afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit gjatë hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit, specifikisht për gjykimin në shkallë të parë dhe për gjykimin në apel. Për sa i përket gjykimit në apel, afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit rregullohen në pikën 3 të këtij neni, ku në shkronjën "c" të të cilit përcaktohet: "*Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit: ... c. Nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm*.". Ndërkohë, neni 265 rregullon rastet e pezullimit nga gjykata të afateve të paraburgimit të parashikuara nga neni 263, për periudha të caktuara kohe.

24. Gjykata vëren se kërkuesja u është nënshtruar masave të sigurimit personal. Gjatë hetimeve paraprake, nën dyshimin për kryerjen e veprës penale "Vjedhja e bankave dhe arkave të

kursimit", të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i KP-së, ndaj saj është caktuar masa e sigurimit "Arresti në burg", masë e cila edhe është zbatuar. Sipas kësaj dispozite, vepra penale në fjalë dënohet në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim. Në përfundim të hetimeve paraprake kërkuesja është akuzuar për këtë vepër penale dhe çështja është dërguar për gjykim. Me vendimin nr. 1730, datë 20.5.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar kërkuesen fajtore për veprën penale që akuzohej, duke e dënuar me 10 vjet burgim. Mbi ankimin edhe të kërkueses, çështja i ka kaluar për gjykim Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjatë shqyrtimit të çështjes në apel, në seancën e datës 24.11.2016, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkuesja, nëpërmjet mbrojtësit të saj, mbështetur në nenet 261, 262 dhe 263, të KPP-së, i ka kërkuar gjykatës së apelit të konstatojë humbjen e fuqisë së masës së sigurimit personal "Arresti në burg", me pretendimin se ndodhej në kushtet e pikës 3, shkronja "c", të nenit 263, të KPP-së, pasi nga data 20.5.2015, kur është dhënë vendimi i fajësisë nga gjykata e shkallës së parë dhe deri atë ditë (në datën 24.11.2016), kishin kaluar më shumë se 9 muaj (në fakt mbi 18 muaj) dhe gjykata e apelit ende nuk e kishte dhënë vendimin e saj.

25. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata konstaton se gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim kërkesën e kërkueses, duke çmuar të mos shprehej në atë moment procedural të gjykimit në lidhje me bazueshmërinë ose jo të saj, por të vijonte me shqyrtimin e çështjes, me arsyetimin se përgjigjja e kësaj kërkese varej nga përfundimi i gjykimit dhe zgjidhja në themel e çështjes. Gjykimi i çështjes ka përfunduar në të njëjtën seancë gjyqësore dhe gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në vendimin e saj, gjykata e apelit ka arsyetuar edhe për kërkesën e kërkueses për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal "Arresti në burg". Sipas gjykatës së apelit, ndonëse konstatimi i mbrojtjes së kërkueses është i vërtetë, në kushtet kur kjo kërkesë është paraqitur në të njëjtën ditë kur gjykohej çështja e themelit dhe kur ajo arrinte në përfundimin se vendimi i dënimit i gjykatës së shkallës së parë për kërkuesen duhet të lihej në fuqi, nuk ka shkak për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" për sa kohë vendimi i saj është i formës së prerë dhe menjëherë i ekzekutueshëm (shih faqen 13 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë).

26. Arsyetimi i lartpërmendur i gjykatës së apelit është konsideruar i drejtë edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka argumentuar se me shpalljen e vendimit të formës së prerë, masat e sigurimit shuhen, për rrjedhojë masa e sigurimit për të cilën kërkohet shuarja, shuhet gjithsesi për këtë shkak të ri. Nga ana tjetër, ky kolegj ka arsyetuar se me shpalljen e vendimit të formës së prerë të dënimit me burgim, ky i fundit fillon menjëherë të prodhojë efekte, çka do të thotë se kërkuesja ka marrë statusin e të dënuarës dhe qëndron në burgim (jo më në paraburgim) për efekt të këtij vendimi, duke u bërë i pamundur lirimi për shkak të humbjes së fuqisë së paraburgimit, sipas parashikimeve të nenit 263, pika 3, të KPP-së. Kolegji Penal ka çmuar, gjithashtu, se qëndrimi në burg gjatë kohës së paraburgimit do të përllogaritet në masën e dënimit që duhet të shlyejë kërkuesja (*shih paragrafin 79 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

27. Nga sa më lart, Gjykata vëren se nga pikëpamja kushtetuese, pritshmëria legjitime e kërkueses në lidhje me kërkesën për humbjen e fuqisë së paraburgimit ka konsistuar në ndërprerjen e paraburgimit dhe lirimin e menjëhershëm të saj nga gjykata. Megjithatë, Gjykata konstaton se në të njëjtën ditë me atë të paraqitjes së kërkesës nga kërkuesja, pas shpalljes së vendimit nga gjykata e apelit, për shkak të dënimit të dhënë prej saj, masa e sigurimit "Arresti në burg" ndaj kërkueses ka humbur fuqinë, ndërkohë që heqja e lirisë për të ka vijuar tashmë në funksion të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë të dënimit. Nisur nga kjo, pavarësisht se gjykata e apelit nuk është shprehur veçmas në lidhje me kërkesën e kërkueses, por së bashku me vendimin përfundimtar dhe gjithsesi në të njëjtën ditë kur kërkesa është paraqitur, Gjykata vlerëson se kufizimi i lirisë së saj personale në vijim nuk rezulton e cenuar për sa kohë paraburgimi i saj ka përfunduar në kuptim të ligjit, duke vijuar heqja e lirisë për të (burgimi) mbi një tjetër shkak kushtetues, ai i dënimit me burgim.

28. Për periudhën e vuajtur të paraburgimit përpara paraqitjes së kërkesës nga kërkuesja për humbjen e fuqisë së masës së sigurimit, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme kanë njohur

shkeljen e së drejtës kushtetuese të kërkueses. Ato kanë pranuar se kohëzgjatja e qëndrimit të saj në paraburgim, në pritje të shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, ka kapërcyer afatin 9-mujor të përcaktuar nga neni 263, pika 3, shkronja "c", i KPP-së, në rrethanat kur gjykata e apelit nuk e ka dhënë vendimin e saj brenda këtij afati nga dita e dhënies së vendimit të dënimit për të nga gjykata e shkallës së parë, ndërkohë që nuk ka pasur disponime nga ana e saj për pezullimin e afatit 9-mujor të paraburgimit për ndonjë periudhë kohore të caktuar, çka, për rrjedhojë, çonte në humbjen e fuqisë së paraburgimit për kërkuesen. Ajo që vihet në diskutim në këtë rast është korrigjimi i shkeljes në momentin e paraqitjes së kërkesës. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se përfundimi si më lart nuk e klasifikon periudhën e paraburgimit në fjalë si burgim të padrejtë në kuptim të nenit 268 e vijues të këtij kodi, vetëm për të cilin ligji i njeh personit të cenuar të drejtën e kompensimit. Nga ana tjetër, sikurse gjykatat e zakonshme janë shprehur, Gjykata vëren se korrigjimi i shkeljes në këtë rast bëhet nga ligji, i cili në kohën e dënimit të vuajtur nga kërkuesja përfshin të gjithë periudhën e paraburgimit. Kështu, neni 465 i KPP-së, që bën fjalë për llogaritjen edhe të paraburgimit, parashikon se në caktimin e kohës së dënimit me burgim, llogaritet edhe periudha e vuajtur e paraburgimit për të njëjtën vepër penale. Kurse neni 57 i KP-së përcakton se një ditë paraburgim është baras me një ditë e gjysmë burgim. Në këtë kuptim, periudha e paraburgimit e vuajtur nga kërkuesja në kapërcim të afatit të përcaktuar nga ligji procedural përfshihet në kohën e dënimit të vuajtur nga ajo, duke u llogaritur kjo periudhë njëlloj sikurse edhe periudha tjetër e paraburgimit. Kërkuesja nuk ka parashtruar ndonjë kundërshtim në këtë drejtim.

29. Gjithashtu, Gjykata nuk mund të mos evidentojë se, pavarësisht pretendimit për humbjen e fuqisë së masës së sigurimit prej disa muajsh, kërkuesja, në fakt, kërkesën e ka paraqitur vetëm në datën 24.11.2016, ditën e gjykimit të çështjes në themel nga gjykata e apelit. Ajo gjatë gjithë procesit gjyqësor është mbrojtur me avokat të zgjedhur prej saj, i cili për shkak të profesionit prezumohet të jetë i njohur me parashikimet e legjislacionit procedural penal, përveçse të ketë edhe aftësitë e nevojshme profesionale për të ndërmarrë çdo akt dhe veprim ligjor në funksion të mbrojtjes së të drejtave të kërkueses në këtë rast. Legjislacioni procedural penal, ndër të tjera, ka për detyrë të mbrojë lirinë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, ku në funksion të kësaj, ndërsa, nga njëra anë, ngarkon me detyrime organet publike subjekte të procedimit penal, nga ana tjetër, u ka dhënë shtetasve mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e tyre, duke kërkuar në këtë kuptim edhe një aktivizëm nga ana e tyre.

30. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se ndonëse për kërkuesen ka pasur cenim të lirisë personale për shkak të tejzgjatjes së paraburgimit në pritje të gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, një shkelje e tillë, e pranuar nga gjykatat e zakonshme, është korrigjuar nga vetë ligji, sikurse më lart u parashtrua. Për rrjedhojë, kërkesa e kërkueses për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme për shkak të cenimit të lirisë personale, është e pabazuar. Për më tepër, shkelja e së drejtës së kërkueses nuk i ka ardhur dhe nuk mund të vijë nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej saj, ndaj ajo nuk mund të përbëjë shkak për shfuqizimin e tyre.

31. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e lirisë personale është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

32. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs, të cilat kishin të bënin me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, të cilat ajo duhet t'i analizonte dhe jo të vendoste mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit.

33. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ky pretendim nuk është i bazuar, pasi Gjykata e Lartë ka analizuar dhe kthyer përgjigje edhe për themelin e pretendimeve të kërkueses, duke vendosur mospranimin e rekursit për shkak të mungesës së shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Vendimi paraqitet i qartë, pa kundërthënie dhe pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e shkaqet e rekursit. Po ashtu, pjesa arsyetuese është në harmoni me konkluzionin se në rastin konkret nuk ka mosrespektim të ligjit penal nga gjykatat e faktit.

34. Në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

35. Gjykata ka theksuar qëndrimin e saj se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime, të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimin nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastet kur kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, është konsideruar se cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pasqyruar në vendimin objekt kundërshtimi shkaqet e ngritura në rekursin e ushtruar nga kërkuesja, ndër të tjera, edhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit", të parashikuar nga neni 136 paragrafi 2, i KP-së, në "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së, me pretendimin se nuk ekziston rrethana e bashkëpunimit me të pandehurin tjetër. Gjykata e Lartë, në referim edhe të vendimit unifikues nr. 4, datë 15.4.2011, të Kolegjeve të Bashkuara, i ka gjetur të pabazuara këto pretendime dhe ka arsyetuar se në rastin konkret plotësohen tërësisht elementet e bashkëpunimit, si nga ana objektive, pasi janë dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash) dhe fakti kriminal është realizuar në të gjitha elementet e tij materiale, si nga elementet e anës subjektive, pasi kontributi i dhënë nga kërkuesja ka qenë rilevant për kryerjen e veprës penale, pasi ka krijuar kushtet për vjedhjen nga i pandehuri tjetër të parave për vite me radhë (*shih paragrafin 81 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sipas asaj gjykate, shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit; nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit penal nga këto gjykata; gjykatat nuk kanë bërë shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit apo shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në dëm të kërkueses (*shih paragrafin 83 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për këto arsye, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses.

37. Në përputhje me standardet e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata çmon se kërkuesja e ka ushtruar plotësisht të drejtën e saj për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Megjithëse me një arsyetim të kufizuar, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të rekursit, duke arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Për më tepër, ajo gjykatë është ndalur dhe u ka kthyer përgjigje pretendimeve të kërkueses, veçanërisht atyre në drejtim të kualifikimit të veprës penale dhe institutit të bashkëpunimit, në interpretim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara. Në këtë mënyrë, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk cenon standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, vetëm fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që Kolegji Penal ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit është i pabazuar.

38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me

standardin e arsyetimit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
Marrë më 13.11.2023.
Shpallur më 18.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj (pjesërisht kundër)
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi
Anëtarë (pjesërisht kundër): Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses Mimoza Bruzia, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 1730, datë 20.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1522, datë 24.11.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-1513, datë 22.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jemi pjesërisht kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se Gjykata duhet të vendoste konstatimin e cenimit të lirisë personale të parë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit. Në vijim do të parashtrojmë argumentet mbi të cilat mbështesim qëndrimin tonë.

2. Kushtetuta në nenin 27 ka parashikuar ndalimin për heqjen e lirisë, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Ndërsa në lidhje me kufizimin e lirisë, kjo dispozitë ka parashikuar rastet ku kjo është e lejueshme nga pikëpamja kushtetuese, mes të tjerash: a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen e veprës penale ose largimin pas kryerjes së saj. Në nenin 28 të Kushtetutës janë parashikuar garancitë procedurale në rastet e heqjes së lirisë, ku përfshihet edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose për t'u proceduar i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.

3. E drejta e lirisë dhe sigurisë personale gjen mbrojtje edhe nga neni 5 i KEDNJ-së, në pikën 1 të të cilit parashikohet se askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: a) kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente; c) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj etj. Sipas GJEDNJ-së, për qëllime të nenit 5, pika 1, shkronja "a", të KEDNJ-së, fjala "dënim" nënkupton konstatimin e fajësisë, pas përcaktimit në përputhje me ligjin se është kryer një vepër penale, si dhe dhënien e dënimit ose të një mase tjetër që përfshin heqjen e lirisë (*shih Del Río Prada kundër Spanjës, nr. 42750/0, § 124, datë 21 tetor 2013*).

4. Në përputhje me delegimin kushtetues rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Dispozitat procedurale, përveç kushteve dhe kritereve për caktimin e masave të sigurimit kanë parashikuar edhe detyrimin që çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori të informojë me shkrim gjykatën që ka caktuar masën

mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht dhe pasi dëgjon palët, gjykata vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit (neni 246, pika 6, i KPP-së).

5. Duke iu kthyer çështjes konkrete, rezulton se, referuar akteve të kësaj çështjeje, kërkuesja është proceduar penalisht për kryerjen e veprës penale "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit", të parashikuar nga neni 136, paragrafi 2, i KP-së. Mbi bazën e kërkesës së prokurorit, në datën 24.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar ndaj saj masën e sigurimit personal "Arresti në burg". Në vijim prokurori ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të kërkueses, e cila ka vijuar të qëndrojë nën masën e arrestit në burg edhe gjatë procesit gjyqësor në shkallë të parë. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 1730, datë 20.5.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka deklaruar fajtore kërkuesen për veprën penale për të cilën akuzohej, duke e dënuar atë me 10 vjet burgim. Ky vendim është ankimuar nga kërkuesja në gjykatën e apelit.

6. Gjatë gjykimit të çështjes së saj në gjykatën e apelit, konkretisht në seancën gjyqësore të datës 24.11.2016, kërkuesja ka kërkuar humbjen e fuqisë së masës së sigurimit "Arresti në burg", për arsye se bazuar në nenin 263, pika 3, shkronja "c" të KPP-së kanë kaluar afatet ligjore pa u dhënë vendimi në gjykatën e apelit. Në po këtë datë, gjykata e apelit ka marrë edhe vendimin për themelin e gjykimit, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për kërkuesen. Kundër vendimit kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila i ka konsideruar të drejta vendimet penale të gjykatave më të ulëta, dhe ka argumentuar se me shpalljen e vendimit të formës së prerë, masat e sigurimit shuhen, për rrjedhojë, masa e sigurimit është shuar gjithsesi për këtë shkak. Me shpalljen e vendimit të formës së prerë të dënimit me burgim, ky i fundit fillon menjëherë të prodhojë efekte, çka do të thotë se kërkuesja ka marrë statusin e të dënuarës dhe qëndron në burgim (jo më në paraburgim) për efekt të këtij vendimi, duke u bërë i pamundur lirimi për shkak të humbjes së fuqisë së paraburgimit, sipas parashikimeve të nenit 263, pika 3 të KPP-së. Po sipas atij vendimi, qëndrimi në burg gjatë kohës së paraburgimit do të përllogaritet në masën e dënimit që duhet të shlyejë kërkuesja (*shih paragrafin 79 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

7. Mbi bazën e rrethanave si më sipër, kërkuesja ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit, me pretendimin se kanë cenuar lirinë personale, në kundërshtim me nenin 27 të Kushtetutës, si edhe të drejtën për proces të rregullt. Shumica ka çmuar t'i analizojë pretendimet e kërkueses në drejtim të lirisë personale dhe së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

8. Për sa i përket pretendimit për cenimin e lirisë personale, shumica, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar se megjithëse kërkuesja ka pasur pritshmëri të ligjshme për t'u liruar për shkak të zgjatjes së paraburgimit përtej afatit ligjor, liria personale e saj nuk është cenuar për sa kohë ajo është dënuar me burgim. Sipas shumicës, shkelja (zgjatja e paraburgimit përtej afatit ligjor) është korrigjuar nga vet ligji, sepse periudha e paraburgimit përtej afatit ligjor llogaritet në kohën e dënimit të vuajtur nga kërkuesja. Në vijim, shumica ka evidentuar se kërkuesja gjatë procesit gjyqësor është mbrojtur me avokat të zgjedhur prej saj, i cili për shkak të profesionit prezumohet të jetë i njohur me parashikimet e legjislacionit procedural penal, përveçse të ketë dhe aftësitë e nevojshme profesionale për të ndërmarrë çdo akt dhe veprim ligjor në funksion të mbrojtjes së të drejtave të kërkueses në këtë rast. Për më tepër, legjislacioni procedural penal u ka dhënë shtetasve mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e tyre, duke kërkuar në këtë kuptim edhe një aktivizëm nga ana e tyre. Për rrjedhojë, sipas shumicës, shkelja e së drejtës së kërkueses nuk ka ardhur dhe nuk mund të vijë nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej saj, ndaj ajo nuk mund të përbëjë shkak për shfuqizimin e tyre (*shih paragrafët 27–30 të vendimit*).

9. Në vlerësimin tonë, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesja ka kërkuar cenimin e *lirisë personale* pasi ka vijuar të qëndrojë në paraburgim në tejkalim të afatit 9-mujor të parashikuar nga neni 263, paragrafi 3, shkronja "c", i KPP-së, çmojmë se pretendimet e saj duhet të ishin vlerësuar në drejtim të kritereve kushtetuese të kufizimit të lirisë në kuptim të nenit 27 të

Kushtetutës dhe garancive procedurale të nenit 28 të saj. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar jo vetëm rëndësinë që merr zbatimi i dispozitave procedurale penale në drejtim të respektimit të lirisë personale, por edhe detyrimin e organeve të pushtetit publik, sipas nenit 15 të Kushtetutës, për të respektuar të drejtën për proces të rregullt ligjor edhe ndaj personave, të cilëve sipas ligjit iu është kufizuar liria, pasi, ashtu si të drejtat e tjera, edhe kjo e drejtë është e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme. Në rastin individëve, liria e të cilëve është kufizuar sipas ligjit, organet e pushtetit publik kanë detyrime shtesë për të dëshmuar se të drejtat kushtetuese të tyre respektohen dhe, pikërisht për këtë arsye, nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës parashikojnë garanci specifike për këtë kategori individësh (*shih vendimin nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, organet shtetërore (përfshi prokurorinë dhe gjykatat) kanë detyrimin t'i respektojnë këto të drejta dhe liri dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

10. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), është shprehur në jurisprudencën e saj se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveç rasteve të parashikuara në nenin 5 të KEDNJ-së dhe vetëm bazuar në ligj (*shih Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 13229/03, § 67, datë 28 janar 2008*). Konventa në thelb i referohet legjislacionit të brendshëm dhe deklaron detyrimin për t'iu përshtatur rregullave materiale dhe procedurale, por gjithashtu çdo heqje lirie duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 5, pra të mbrojë individët nga arbitrariteti (*shih vendimet e GJEDNJ-së Bozano kundër Francës, datë 18.12.1986, paragrafi 54; Lukanov kundër Bullgarisë, datë 20.3.1997, paragrafi 41*).

11. Po sipas GJEDNJ-së, paraburgimi në çështjet penale kërkon intervale të shkurtra ndërmjet rishikimit të vendimeve (*shih Bezicheri kundër Italisë, 1989, § 21*). Nëse koha përpara marrjes së një vendimi është prima facie e papajtueshme me nocionin e shpejtësisë së gjykimit, Gjykata do të kërkojë nga shteti që të shpjegojë arsyen e vonesës ose të parashtrojë arsye të jashtëzakonshme për të justifikuar kalimin e kohës në fjalë (*shih Musiał kundër Polonisë [GC], 1999, § 44; Koendjbiharie kundër Holandës, 1990, § 29*). As ngarkesa e tepërt e punës dhe as periudha e pushimeve nuk mund të justifikojnë një periudhë pasiviteti nga ana e autoriteteve gjyqësore (*shih E. kundër Norvegjisë, 1990, § 66; Bezicheri kundër Italisë, 1989, § 25*).

12. Siç kemi theksuar më sipër, kërkuesja përgjatë kohës që çështja ka qenë në fazën e hetimit dhe deri në dhënien e vendimit nga gjykata e apelit ka qenë nën masën e sigurimit personal "Arresti në burg". Sipas nenit 263, pika 3, të KPP-së, paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit: c) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. Vendimi i dënimit për kërkuesen me burgim është dhënë në datën 20.5.2015, nga gjykata e shkallës së parë, dhe në datën 24.11.2016, kur është dhënë vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, kishte kaluar një periudhë prej 18 muajsh, pra ishte tejkaluar afati 9-mujor. Në Gjykatën e Apelit rezulton që çështja të jetë mbajtur pa veprime dhe është caktuar vetëm kjo seancë e datës 24.11.2016, ndonëse kërkuesja ndodhej nën masën e sigurimit "Arresti në burg".

13. Edhe pse kërkuesja nuk ka paraqitur kërkesë për shuarjen e kësaj mase pas kalimit të afatit ligjor, ashtu siç arsyeton shumica (*shih paragrafin 29 të vendimit*) dhe pavarësisht se në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se palët duhet të tregojnë kujdesin e duhur në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore, në rastin konkret natyra e së drejtës që vihen në diskutim, që është ndalimi i kufizimit të lirisë personale nëse nuk plotësohen kërkesat ligjore, bënte të nevojshme trajtimin e kësaj çështjeje në këndvështrim të detyrimit të organeve shtetërore për zbatimin e parashikimeve të nenit 246, pika 6, të KPP-së dhe detyrimeve aktive të prokurorit dhe gjykatës, që shqyrtimi i çështjes në gjykatën e apelit të bëhej brenda afatit ligjor 9 mujor. Edhe pse gjykatat e zakonshme kanë konstatuar kalimin e afateve ligjore ato nuk janë shprehur as për veprimet e kryera nga prokuroria dhe vetë gjykatat për verifikimin e nevojave të sigurimit në rastin e kërkueses dhe as për shuarjen e masës së sigurimit, por kanë bazuar arsyetuar se me shpalljen e vendimit të formës së prerë të dënimit me burgim, ky i fundit fillon menjëherë të prodhojë efekte, çka do të thotë se kërkuesja ka marrë statusin e të dënuarës dhe qëndron në burgim (jo më në paraburgim) për efekt të këtij vendimi,

duke u bërë i pamundur lirimi për shkak të humbjes së fuqisë së paraburgimit, sipas parashikimeve të nenit 263, pika 3 të KPP-së. Kolegji Penal ka çmuar, gjithashtu, se qëndrimi në burg gjatë kohës së paraburgimit do të përllogaritet në masën e dënimit që duhet të shlyejë kërkuesja.

14. Siç ka pranuar edhe shumica, në parim, legjislacioni procedural penal u ka dhënë shtetasve mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e tyre, duke kërkuar në këtë kuptim edhe një aktivizëm nga ana e tyre, në rastin në shqyrtim, për shkak se kërkuesja ndodhej në kushtet e izolimit, një aktivizëm të tillë e vlerësojmë barrë të tepruar për të. Për më tepër, në kushtet kur legjislacioni procedural ka parashikuar garanci të posaçme për personat ndaj të cilëve është vendosur një masë sigurimi personal, organet shtetërore duhet të luajnë një rol aktiv në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave kushtetuese të individëve, përfshi edhe kontrollin sistematik gjyqësor të kushteve të masës së sigurimit, për shkak të ndërhyrjes që ajo bën në lirinë personale të individit. Në këtë pikëpamje, me anë të këtyre procedurave, autoritetet gjyqësore kanë detyrimin që individit t'i garantojnë të gjitha standardet e duhura për mbrojtjen efektive në rastet e heqjes arbitrare të lirisë.

15. Në analizë të sa më lart, ne gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se pretendimi i kërkueses për cenimin e lirisë personale është i bazuar. Nga ana tjetër, vlerësojmë se mënyra se si e kanë trajtuar gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kërkesën e kërkueses dhe pretendimet e saj me natyrë kushtetuese, vë në dyshim edhe standardin e arsyetimit të atyre vendimeve.

16. Megjithatë, ashtu siç Gjykata ka mbajtur qëndrim edhe në raste të tjera (*shih vendimin nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), kur pavarësisht konstatimit të shkeljes së të drejtave themelore dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për kërkuesin, në këtë rast për shkak se tashmë kufizimi i lirisë personale është pasojë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të dënimit të formës së prerë, shumica duhet të shprehej vetëm për konstatimin e cenimit të lirisë personale.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci